



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3334 / Prot.
2

Tiranë, më 23 .12 .2021

VENDIM

Nr. 71, datë 23 .12 .2021

PËR

**“MIRATIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË HAPJES/RIORGANIZIMIT TË
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, 47 e vijues, Udhëzimit nr. 7, datë 31.03.2021 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i ndryshuar, Statutit të UMT-së, neni 51 si dhe të Vendimeve të Senatit Akademik nr.72, datë 30.09.2021 “Për miratimin e propozimeve për hapjen/riorganizimin e doktoratave në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe nr.101, datë 16.12.2021 “Për një shtesë në vendimin e Senatit Akademik nr. 72, datë 30.09.2021 “Për miratimin e propozimeve për hapjen/riorganizimin e doktoratave në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë“, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë efektet financiare të hapjes/riorganizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, (sipas shtojcës 1 bashkëlidhur).
2. Efektet financiare të hapjes/riorganizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” do të përballohen nga të ardhurat e njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Tarifa e studimit për programet e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” do të jetë 600,000 (gjashtëqind mijë lekë), sipas propozimit të unifikuar të departamenteve përkatëse të njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i UMT-së, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

5. Ngarkohet Sektori i Kordinimit Institucional, për publikimin e Vendimit në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI



ANËTARË

VERA OSTRENI



ALTINA XHAFERI



ALBANA GJINOPULLI



ENDRIT YZEIRAJ



MONIKA FIDA



ANIS THODHORJANI

Shtojca I

❖ Fakulteti i Mjekësisë

- Doktoratë në Neurokirurgji
- Doktoratë në Neurologji
- Doktoratë në Shëndet Mendor
- Doktoratë në Pediatri
- Doktoratë në Shkenca Farmaceutike
- Doktoratë në Reumatologji
- Doktoratë në Pneumologji
- Doktoratë në Nefrologji-Dializë-Transplant
- Doktoratë në Hematologji
- Doktoratë në Gastroenterologji/Hepatologji
- Doktoratë në Endokrinologji/Diabetologji
- Doktoratë në Shëndet Publik
- Doktoratë në Alergologji
- Doktoratë në Mjekësi Laboratorike
- Doktoratë në Mjekësi Interne
- Doktoratë në studime të thelluara kërkimore/aplikative në Farmakologji, Fiziologji dhe Fiziopatologji
- Doktoratë në studime të thelluara në kardiologji
- Doktoratë në Kirurgji të përgjithshme dhe nënspecialitete
- Doktoratë në Okulistikë
- Doktoratë në Otorinolaringologji
- Doktoratë në Obstetrikë-Gjinekologji
- Doktoratë në Studime të thelluara anatomo-imazherike dhe cito-patologjike
- Doktoratë në Semiologji klinike dhe imazheri
- Doktoratë në Mjekësi familje
- Doktoratë në Sëmundje Infektive
- Doktoratë në Dermatologji Venerologji

❖ Fakulteti i Mjekësisë Dentare

- Doktoratë në Kirurgji oro maxilo faciale
- Doktoratë në Teknologji Dentare dhe Ortodonci
- Doktoratë në Shkenca Dentare

❖ Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

- Doktoratë në Infermieri dhe Mami
- Doktoratë në Teknologji Mjekësore Diagnostikuese dhe Trajtuese
- Doktoratë në Fizioterapi dhe Rehabilitim

❖ Doktoratë e përbashkët me Universitetin e Bologna, Itali

- Doktoratë në Mjekësi interne
- Doktoratë në Kirurgji të përgjithshme dhe nënspecialitete
- Doktoratë në Obstetrikë-gjinekologji